



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER

Nr. 6166 / Prot.  
1

Fier, më 28/05/2026

**URDHËR**

**“Për Krijimin e Zyrës Lokale të Ankesave (ZLA)”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe në kuadër të zbatimit të projektit “Qëndrushmëria ndaj Klimës dhe Zhvillimit të Bujqësisë”(CRAD), mbi zhvillimin e projekteve Rikonstruksioni i Laboratorit Rajonal të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Instalimin e Paneleve Fotovoltaike në Hidrovorët Hoxhara 1 dhe Sheq për prodhimin vetjak të energjisë si dhe Ndërtimi i Mikro Qendrës Ushqimore MQU financuar nga Banka Botërore:

**URDHËROJ:**

1. Të krijohet zyra lokale e ankesave pranë Bashkisë Fier, Njësitë Administrative Dërmënas dhe Topojë.
2. Personat përgjegjës për këtë zyrë do të jenë Ervis Rista Bashkia Fier, Kleo Muhametaj Njësia Administrative Dërmënas dhe Aleksandër Kola Njësia Administrative Topojë.
3. Struktura do të menaxhojë ankesat e qytetarëve dhe do të bashkërendojë procesin me përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Njësia Administrative Dërmënas, Njësia Administrative Topojë dhe personat e mësipërm.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Armando SUBASHI**